

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVËRBAL

nga mbledhja e -III-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
14 mars 2019 në sallën e komunës, e cila filloi në ora 10:35.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Shpëtim Zhegrova, Melihate Basholli-Latifi, Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Lutfi Bilalli (i cili ka dhënë dorëheqje).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Besim Muzaqi (nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Afrim Namani, Saranda Cakaj, Berat Sadiku, Adnan Lahu, Miran Halili, Berat Asllani dhe Bajrush Kosumi), si dhe nga sekretaria, Haki Maloku, Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Aliu deklaroi se raportet e ndërmarrjeve regjionale "Uniteti" dhe "Mitrovica" nuk na janë sjellë, por shpresojmë deri në kuvend që do t'i dërgojnë, edhe pse kemi pasur një arsyetim verbal nga Drejtoria për Shërbime Publike se do t'i sjellin për kuvend. Pastaj deklaroi se disa pika kanë ardhur për t'u proceduar edhe në të ndryshme, i cili kërkoi që të futen në rend të ditës.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – kërkoi informatë lidhur me arsyen e shkarkimit të drejtorit të Shërbimeve Publike, Sedat Rashica. Ai theksoi se si anëtarë të KPF-së duhet të njoftohemi se pse është shkarkuar për keqmenaxhim apo keqpërdorim.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – deklaroi se kryetari i komunës, i cili ka marrë vendim për shkarkimin e drejtorit sot nuk është i pranishëm që ta jep arsyen e shkarkimit.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14 shkurt 2019;
2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2018;
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit ndihmës;

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e komitetit për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së;
6. Shqyrtimi i Planit komunal të veprimit për efikasitet të energjisë;
7. Shqyrtimi i kërkesës së anëtarit të kuvendit lidhur me KPF-në;
8. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14 shkurt 2019.

Melihate Basholli, anëtare e KPF-së – tha se në faqen 3 lidhur me funksionalizimin e aparatit të mamografisë kam bërë konstatim e jo pyetje. Kam thënë se ne si komunë çka mund të bëjmë, në mënyrë që aparati i mamografisë të jetë funksional, pasi që qytetarët kanë nevojë për atë. Po ashtu në faqen 6, ajo tha se ka kërkuar që të ketë kontroll lidhur me ligjëratat që mbahen në shkollë, si dhe ata që i mbajnë ligjëratat të jenë njerëz të trajnuar, në mënyrë që t'i vetëdijësojnë nxënësit për dukuritë negative në shoqëri dhe për pasojat. Në fund kërkoi që të bëhen këto përmirësime në procesverbal.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri me ndryshime aprovoi procesverbalin e datës 14.2.2019.

2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2018.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – kërkoi sqarime se pse veturat me regjistrim <01> (me lising) nuk janë të përfshira në asnjë raport, pra as shpenzimet, as forma e kontratës. Në faqen e komunës të projektet e realizuar në vitin 2018 kërkoi informatë se pse në rrugën “Sherif Kolla”, L=170m, ndërtimi i rrugës me kubëza betoni ka kushtuar 10,459.80€, kurse në rrugën “Mustafë Çuka”, L=200m, b=3m ka kushtuar 4,814.00€? Kurse, te <ndërtimi i rrugëve me kubëza, "Rrahim Sylja" L=207, b=3m> ka kushtuar 85.000€. Shpresoj se është ndonjë gabim teknik. Ai tha se nëse ka gabime është mirë të përmirësohen.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - theksoi se pjesa e korrigjimit të fundit ende nuk është bërë. Lidhur me këtë, ka mundësi që janë bërë gabime teknike, pasi që në fillim kanë qenë projektet e rrugëve me kubëza si total, kurse më vonë i kam kërkuar Idrizit që të shkohet për secilën rrugë veç e veç. Prandaj, po dyshoj që ka mund të rrjedhë ndonjë gabim teknik.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – theksoi se në kodin ekonomik <qiraja-makineria> për automjetet me lising janë paguar deri më tani për katër automjete 8672.72 euro, kurse marrëveshjen e ka Drejtoria për Prokurim dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

Melihate Basholli, anëtare e KPF-së – pyeti se a lejohet regjistrimi i veturave me<01>?

Saranda Cakaj, drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim – tha se lejohet regjistrimi edhe me <01>, kurse tani na ka ardhur një shkrësë për kthim të tabelave në <02Z>. Ajo deklaroi se sa i përket kontratës së lisingut, këto kontrata janë zhvilluar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – qëllimi im ishte që ta dimë se sa po harxhon komuna për shpenzimet e karburanteve, sepse në çdo formë tjetër komuna do të harxhojë më pak në raport me veturat e vjetra që i posedon. Prandaj, qeverisja komunale do të ishte mirë ta gjejë një formë për heqjen e veturave të vjetra nga përdorimi.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se në faqen 7, pika 13 <Asfaltimi i rrugës Stanoc-Lumadh-Prelluzhë-Gracë (projekt dyvjeçar)>, po shkruan që projekti është realizuar. Ai pyeti se si quhet kjo rrugë që i lidh këto fshatra? A ka filluar ky projekt të realizohet? Gjithashtu kërkoi informatë me shkrim se sa është numri i vendeve të lira në Administratën komunale të Vushtrrisë.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – theksoi se sa i përket rrugëve në Stanoc, kanë qenë katër rrugë që janë përcaktuar nga komisioni i Drejtorisë për Urbanizëm, tri prej tyre veç kanë përfunduar, kurse një rrugë vetëm sa ka filluar, ku të gjitha mjetet e grantit të vitit të kaluar janë shpenzuar, kurse ka mbetur edhe një pjesë e të hyrave vetanake që janë bartur në këtë vit, kurse kompania ka dalë në terren dhe është duke punuar. Pastaj ai deklaroi se një rrugë që lidh këto fshatra nuk ekziston.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – lidhur me atë që e thashë më lartë, aty po flitet për një rrugë që i lidh fshatrat e lartcekura në projekt. A është devijuar projekti apo çka është në pyetje. Kjo çështje është dashur të vjen në kuvend, tha ai.

Saranda Cakaj, drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim – deklaroi se emërtimi nuk mund të ndryshohet, pasi që në procedurë ka hy me këtë emërtim, e cila ka qenë e planifikuar në mandatin e kaluar.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – tha se ky është një projekt dyvjeçar që është planifikuar në vitin 2017, për t'u realizuar në vitin 2018. <Asfaltimi i rrugës Stanoc-Lumadh-Prelluzhë-Gracë> Pra, ka qenë e planifikuar si rrugë që i lidh këto fshatra. Ne si subjekt politik e kemi planifikuar që ta ngrini si shqetësim këtë çështje, sepse është bërë devijimi i projektit. Nëse është devijuar projekti, është dashur të vjen në kuvend dhe t'i ndërrohet destinimi. Zhegrova theksoi se instancat tjera do ta vërtetojnë se a ka pasur devijim të projektit apo jo.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se në fillim kur është bërë planifikimi ka pasur lëshime, sepse është dashur të ceket emri i rrugës.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – cilët janë emrat e rrugëve që janë emërtuar në vitin 2019?

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – kërkoi sqarim plotësues për kuvend lidhur me këtë rrugë. Ne kemi votuar që secila rrugë t'i ketë specifikat e veta dhe jemi dakorduar që të na vijnë në KPF.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – kërkoi përgjigje se cilat rrugë janë asfaltuar në Stanoc dhe sa ka qenë planifikimi i tërë projektit për këto rrugë?

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - tha se për vitin 2019 është dakordimi që në KPF të vjen lista e rrugëve, qoftë me asfalt apo me kubëza dhe pastaj të procedohen në kuvend.

Saranda Cakaj, drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim – në bazë të tabelës së dhënë, ku thuhet se <projekti është realizuar> dhe është vendosur <po> ose <jo>, ajo sqaroi në momentin që kryhet procedura nga prokurimi (nënshkrimi i kontratës) në e vendosim <po>, por kjo nuk do të thotë që është kryer projekti.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri kërkoi që të plotësohet dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – sqaroi se si drejtori iu kemi përmbajtur kategorive ekonomike ashtu qysh kërkohet nga ministria. Nga tri projektet që janë bartur mjete më shumë janë: ndriçimi publik, ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave, kurse, projektet tjera janë projekte në vazhdim e sipër që jemi të obliguar t'i kryejmë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se në krahasim me vitet e kaluara, shumë mjete kanë tepruar. Tek kategoria <mallra dhe shërbime> janë destinuar shumë mjete financiare, a do të thotë kjo që për shkak të punësimeve me kontrata të veçanta janë planifikuar mjete më shumë në këtë kategori. Ai pyeti se pse tek subvencionet s'po rritet shuma financiare?

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se kemi bërë kërkesë në ministri për rritjen e mjeteve financiare tek kategoria e subvencioneve, por nuk na kanë lejuar.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit ndihmës.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – i informoi të pranishmit lidhur me këtë propozim-vendim. Ai theksoi se tek neni 1 dhe arsyetimi është një gabim teknik <stadiumi ndihmës> dhe duhet të jetë <stadiumi ndihmës i futbollit>, kurse për kuvend do të përmirësohet.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti se kjo pronë mos është nën komasacion? Po ashtu, Klinaku propozoi që të ketë edhe një pronë rezervë, për shkak se nëse na kthehet negativ nga ministria, e kemi pronën tjetër të gatshme dhe mos të humb donacioni.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – theksoi se lidhur me këtë, i kemi dy propozime të gatshme, nëse eventualisht kthehet nga ministria.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e komitetit për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së – lidhur me këtë, jemi konsultuar me zyrën ligjore dhe zyrën e kuvendit për ta gjetur një modalitet për një funksionim sa më të mirë të këtij komiteti, po ashtu edhe këtu bashkërisht të bisedojmë për gjetjen e një zgjidhjeje që të funksionojë në praktikë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se si komitet joobligativ konsideroj se do të funksionojë mirë, ku ai përmendi Komunën e Ferizajt që e ka themeluar një komitet të tillë. Ne si komitet mund ta autorizojmë kryesuesin e kuvendit që të bisedojë me shoqatat e dala nga lufta, t'i marrë propozimet prej tyre dhe ta gjejmë një modalitet për themelimin e këtij komiteti.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – propozoi që ky komitet të themelohet si komitet konsultativ dhe të jenë të gjithë përfaqësues të shoqatave.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së – theksoi se përzgjedhja e anëtarëve në komitetet konsultative bëhet me shpallje publike dhe ndoshta do të na e vështirësojë themelimin e këtij komiteti me përfaqësim nga organizatat. Nëse shkojmë me themelim të komiteteve tjera, atëherë shumica e anëtarëve duhet të jenë nga kuvendi për shkak të vendimmarrjes. Sepse, me udhëzim administrativ kufizohet numri i anëtarëve në pesë (5). Kjo do të thotë që nga kuvendi duhet të kemi tre anëtarë, për shkak se sipas këtij udhëzimi thuhet që anëtarët jashtë kuvendin nuk kanë të drejtë vote, theksoi Aliu.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që deri në kuvend të analizohen modalitetet dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

6. Shqyrtimi i Planit komunal të veprimit për efikasitet të energjisë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se edhe në planin e kaluar, por edhe në këtë plan të veprimit, (i cili qenka përgatitur nga një autor i huaj) ka të dhëna të gabuara. P.sh. te palestra e sportit, kulmi nuk ka izolim, kurse konsumi specifik del të jetë 14 kWh/ m² në vit, që i bie se ky objekt është super i izoluar. Me këtë konsum specifik, nuk kemi as në Gjermani e as në Zvicër me kaq pak harxhime. Duhet të kemi kujdes te këto të dhëna, se nga ky plan mund të kemi përfitim edhe për renovim të ndonjë objekti. Po ashtu, duhet të hiqet objekti i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë nga prioritetet, pasi që është duke u rinovuar dhe të vendoset në prioritet ndonjë shkollë apo objekt tjetër. Asnjë donacion për objekte nuk mund të përfitojmë pa u bërë auditimi i energjisë, tha Klinaku, ndërkaq ky plan po na del kopje nga Komuna e Skënderajt, sepse në disa vende haset Skënderaj, në vend që të jetë Vushtri.

Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë për Arsim – deklaroi se nga Drejtoria për Arsim, zyrtar kontaktues për fushën e energjisë është Agim Miftari. Ai tha se nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik sipas planit për efikasitet elektrike janë kryer dy shkolla: “Lutfi Musiqi” dhe shkolla në Vërnice, kurse me KFOR-in turk edhe shkolla “Naim Frashëri. Ai tha se ministria na i ka kërkuar edhe tri shkolla tjera, pasi që është rritur fondi. Mirëpo, nuk e dimë ende se cilat projekte janë pranuar.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës.

7. Shqyrtimi i kërkesës së anëtarit të kuvendit lidhur me KPF-në.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së – tha se lidhur me këtë, e kemi një shkresë nga anëtari i kuvendit dhe komitetit, Nezir Klinaku.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se qysh nga fillimi ka pasur probleme tek përbërja e KPF-së. Më 31.12.2019 ministri i MAPL-së e ka nënshkruar Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2014 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë. Me këtë udhëzim, precizohet qartë edhe kriteri gjinor, ku thuhet se duhet të sigurohet përfaqësim prej 50% për secilën gjini. Në nenin 5 të këtij udhëzimi janë dy pika: Pika 1 thotë që KPF-ja përbëhet nga përfaqësuesit e subjekteve politike që përfaqësohen në kuvend, kurse, pika 2, thotë se nëse në kuvend janë të përfaqësuara më shumë entitete politike, me çka bëhet e pamundur përfshirja e të gjithave, atëherë përfaqësimi do të bëhet në bazë të përqindjes së përfaqësuar në kuvendin e komunës. Pra, ose do të zbatohet pika e parë ose pika e dytë, marrëveshje të fshehta nuk do të ketë, tha Klinaku. Sipas tij, nëse zbatohet pika e dytë, atëherë unë do të japë dorëheqje, sepse Lëvizjes për Bashkim nuk i takon përfaqësimi në KPF. Prandaj, të përcaktohet se kujt i takon, duke respektuar edhe kriterin gjinor dhe të funksionojë KPF-ja ashtu siç duhet. Përmes shkresës kam thënë se jap dorëheqje nga KPF-ja nëse e sillni në kuvend dhe përcaktoheni që ta zbatoni pikën 2 të këtij udhëzimi.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se kur është themeluar KPF-ja, PDK-së i është bërë e padrejtë në bazë të përqindjes së përfaqësimit që ka në kuvend, pasi që në KPF na kanë takuar t'i kemi tre anëtarë. Nëse veç sillet në kuvend, ne do ta japim qëndrimin tonë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – Shpëtimi deklaroi se PDK-së i është bërë e padrejtë në rastin e themelimit të KPF-së, por kjo nuk qëndron, sepse me udhëzimin administrativ nr. 03/2014 ka qenë që të ketë përfaqësim sa më shumë të entiteteve politike, kurse tani me udhëzimin administrativ nr. 02/2018 është e sqaruar më mirë.

Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore – deklaroi se sipas udhëzimit administrativ nr. 02/2018 është obligim i kuvendeve komunale që deri më 31 mars 2019 ta bëjnë harmonizimin, përbërjen dhe numrin e komiteteve. Komiteti për Komunitete në komunën tonë ka 9 anëtarë, kurse me këtë udhëzim administrativ parashihet që t'i ketë 5-7 anëtarë. Lidhur me atë që e tha Neziri, është çështje e kuvendit se për cilin version përcaktohet për KPF-në.

8. Të ndryshme.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se Memorandumi i mirëkuptimit në mes të komunës dhe kompanisë “Uniteti” për grumbullimin e mbeturinave ka qenë i nënshkruar deri më datën 31.12.2018, kurse aktualisht nuk ka memorandum lidhur me këtë çështje, pavarësisht se janë shkelur dispozitat ligjore kur është nënshkruar ky memorandum, kështu që tani kemi shkelje edhe më të mëdha, sepse po bëhen pagesa pa memorandum. Ai kërkoi informatë me shkrim se:

➤ Pse po paguhen mjetet financiare pa memorandum ?

- Pse nuk po paguhet fatura e plotë që kompania “Uniteti” e dërgon në Komunën e Vushtrrisë?

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – lidhur me Memorandumin e mirëkuptimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Bashkësisë Islame-dega në Vushtri, kërkoi informatë me shkrim se:

- A do të bëhen pagesat në mënyrë retroaktive nga data 1 janar 2019 deri më 24 janar 2019? (pasi që më 24 janar 2019 është nënshkruar memorandumi për këtë vit).

Lidhur me këtë, Klinaku theksoi se ka pasur raste kur Bashkësia Islame diku i ka kryer e diku nuk i ka kryer shërbimet gjatë kohës kur nuk është nënshkruar memorandumi i ri. Ai kërkoi nga kryesuesi i kuvendit që vlerësimet e ligjshmërisë që vijnë nga MAPL-ja të na dërgohen neve si anëtarë të kuvendit, sepse është obligim ligjor që të na dërgohen, pasi që ne si anëtarë të kuvendit jemi ata që marrim vendime. Prandaj, ose ti si kryesues na i dërgon ose obligoje sekretarinë e kuvendit të na i dërgon në e-mail.


Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së – tha se jam dakord që t’ua përcjellim vlerësimet e ligjshmërisë anëtarëve të kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën **12:00**.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku

Procesmbajtës



Nasuf Aliu

Kryesues i KK-së dhe i KPF- së